

MA-P nof. P3.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM
Nr.8 Datë 09/02/2011

**“Për
miratimin e anulimit të lejes për përdorim uji të imbotiluar nga burimi
Bogove Skrapar të shoqërisë “Castele Park Konstrukcion” sh.p.k”**

Në mbështetje të neneve 8, 17 pika “b” të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, të Vendimit nr.3, datë 19.07.2002 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshillit të Basenit Ujëmbledhës dhe Agjencisë së Ujit” Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e anulimit të lejes të subjektit “Castele Park Konstrukcion” për shfrytëzimin me koncesion të burimit ujor Bogove Skrapar, Qarku Berat, për mos realizimin e investimeve të paraqitura në projekt.

Specifikimet e burimit ujor:

Koordinatat e burimit ujor janë
 $x = 4429800$ $y = 4493125$ $z = 295$ m

Sasia e ujit që jepet në përdorim është; $Q = 5$ l/sek.

Ngarkohet AUB Seman për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËSI AUB
SEMAN
Saimir HOXHAI**



**KRYETARI I KBU
SEMAN
Bujar HASAJ**

